



REPUBLIKA E KOSOVËS

KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË



ASSEMBLY OF MALISHEVA



Kuvendi i Komunës

Nr. 02/

Datë: 07.11.2019

PRANUAR ME

ACCEPTED ON

PRIMLJENO

Nr.No.Br.

08.11.2023

02/513

Në bazë të nenit 11, nenit 12 paragrafi 2 pika d, nenit 17, nenit 40 paragrafi 2 pika c, të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr.28/15, qershor 2008"), nenit 2 paragrafi 2.1, 2.3 të Ligjit nr.03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr.27/03 qershor 2008"), nenit 17 paragrafi 1 të Ligjit nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, Statutit të Komunës së Malishevës nr. 02/441 të datës, 14.09.2023, kërkesës nr.02/489 datë:13.10.2023, Kuvendi i Komunës së Malishevës me datë, 31.10.2023, mori këtë

V E N D I M

Për caktimin e lartësisë së kompensimit mujor për anëtarët e Komisionit të Aksionarëve, NPK "Stacioni i Autobusëve" Sh.a në Malishevë, dhe KRM "Ekoregjioni" Sh.a, njësia në Malishevë.

1. Miratohet kërkesa nr. 02/489 datë, 13.10.2023 e parashtruar nga Kryesuesi i Komisionit Komunal të Aksionarëve të N.P.K " Stacioni i Autobusëve " Sh.a, në Malishevë, për caktimin e lartësisë së kompensimit mujor për anëtarët e Komisionit të Aksionarëve, NPK "Stacioni i Autobusëve" Sh.a në Malishevë
2. Bazuar në pikën 1 të këtij vendimi Kuvendi i Komunës së Malishevës, mori vendim që Anëtarët e Komisionit të Aksionarëve për N.P " Stacioni i Autobusëve " Sh. a dhe Komisionit të Aksionarëve të KRM " Ekoregjioni " Sh.a, njësia në Malishevë, të kompensohen me 200 € dhe me nga 50 €, për çdo takim.
3. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset kryetari i komunës, përmes drejtorisë për ekonomi, financa dhe buxhet.
4. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Malishevës, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, konform nenit 81 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 17 të Rregullores nr.01/2017, për procedurën e hartimit dhe publikimit të akteve të Komunës, dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose ueb-faqen e Komunës.

Vendimi ju dërgohet

MAPL-së.

Drejtorisë për Ekonomi, Buxhet dhe Financa

Arkivit të Komunës



Kryesuesi i Kuvendit
Argjend Thaçi



PRANUAR ME:
ACCEPTED ON: 13-10-2023
PRIMLJENO:

No. Nr. 02/489



Komisioni i Aksionarëve N.P.K "STACIONI I AUTOBUSËVE" SH.A. MALISHEVË

KËRKESË

NGA: Komisioni i Aksionarëve N.P.K "STACIONI I AUTOBUSËVE" SH.A. MALISHEVË	
Datë: 13.10.2023	
PËR:	Komitetin për Politik dhe Financa
LËNDA: PËR CAKTIMIN E LARTËSISË SË KOMPENZIMIT MUJOR PËR ANËTARËT E KOMISIONIT KOMUNALE TË AKSIONARËVE NË NLP "STACIONI I AUTOBUSËVE" NË MALISHEVË	

Komisioni i aksionarëve të NPL Stacioni i Autobusëve SH.A, në mledhjen e mbajtur me datë: 13.10.2023, miraton me vota unanime kërkesën për caktimin e kompensimit mujor për anëtarët e komisionit Komunal të Aksionarëve në NPL "STACIONI I AUTOBUSËVE" në Malishevë.

1. Shuma e kompensimit të rregullt mujor për secilin anëtarë të Komisionit Komunal të Aksionarëve në NLP "STACIONI I AUTOBUSËVE" në Malishevë, caktohet në lartësi prej 200,00 € (dyqind euro) si dhe plus 50€ (pesëdhjetë euro) për çdo takim të mbajtur, por jo më shumë se për gjashtë takime brenda vitit.
2. Mjetet për kompensimin anëtarëve të Komisionit komunal të aksionarëve ndahen nga Buxheti i Komunës-Kodi buxhetor i pagave dhe mëditjeve të Drejtorisë për Ekonomi dhe financa.

Arsyetim: Duke patur parasysh punën intensive, të përditshme të komisionit që nuk reduktohet vetëm në mledhjet e mbajtura mujore, vendimet e të cilit kanë pasoja juridike, dhe po ashtu duke u bazuar edhe në praktikat nga komunat tjera, Komisioni i Aksionarëve të kësaj ndërmarrje kërkon nga Komiteti për Politik dhe Financa ta shqyrtoj dhe ta rekomandoj për kuvend kërkesën në fjalë.

Kryesuesi i Komisionit Halil Morina



16. Kryesuesi i Komisionit/Bordit që kompensohet sipas Rregullores (QRK) Nr. 10/2023, dhe që mbledhet të paktën një (1) herë në muaj, në fillim të çdo muaji përcjell listën e pjesëmarrjes në takime të Komisionit/Bordit tek ZKA i Institucionit që ka nxjerrë vendimin për themelimin e Komisionit/Bordit.

Në rast se Komisioni/Bordi mbledhet më rrallë se një (1) herë në muaj, Kryesuesi e përcjell listën e pjesëmarrjes sipas pikës 12. të kësaj Qarkoreje, çdo herë pas mbledhjes së Komisionit/Bordit.

**Qarkore rreth zbatimit të Rregullores (QRK) Nr. 10/2023 për Kompensimin për
Funksionin Shtesë**

1. Rregullorja (QRK) Nr. 10/2023 për Kompensimin për Funksionin Shtesë është publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe ka hyrë në fuqi më 6 shkurt 2023, në përputhje me nenin 38 të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik.
2. Rregullorja përcakton kriteret për kompensim të zyrtarëve publik të cilët emërohen/caktohen që të shërbejnë në borde, komisione profesionale apo organe tjetra publike, që kërkojnë ekspertizë profesionale dhe përbëjnë funksion shtesë nga detyrat e punës së zyrtarit publik.
3. Rregullorja ka përcaktuar kriteret për përfitim të këtij kompensimi, të cilat duhet të përmbushen në mënyrë kumulative:
 - 3.1. themelimi i Komisionit/Bordit parashihet në ligj apo akt nënligjor;
 - 3.2. përfshirja në Komision përbën funksion shtesë për zyrtarin publik;
 - 3.3. funksioni nuk bën pjesë tek detyrat e obligueshme të pozitës të cilën zyrtari publik e mban;
 - 3.4. përfshirja në Komision kërkon ekspertizë profesionale të cilën zyrtari e posedon;
 - 3.5. Komisionet/Bordet të cilat kanë kompetenca vendimmarrëse në procedurë administrative; dhe,
 - 3.6. Komisioni/Bordi nuk themelohet nga institucioni ku zyrtari publik është i punësuar.
4. Rregullorja përcakton se kompensim për funksion shtesë në asnjë mënyrë nuk iu takon zyrtarëve që caktohen të shërbejnë në ndonjë grup, ekip punues, autoritet apo organe të ngjashme, dhe shërbimi konsiderohet pjesë e detyrave të obligueshme të zyrtarit. Rrjedhimisht, zyrtarët nuk mund të kërkojnë Kompensime për pjesëmarrje në grupe punuese për hartim të legjislacionit, strategjive, politikave dhe të ngjashme, pavarësisht se a hartohet dokumenti në institucionin ku janë të punësuar, apo delegohen si përfaqësues të institucionit përkatës në një institucion tjetër publik.
5. Kompensimi gjithashtu nuk u takon zyrtarëve për kryerjen e detyrave dhe përgjegjësi që rrjedhin nga pozita që e mbajnë, duke përfshirë këtu edhe pjesëmarrjen në komisione dhe/apo organe të tjera të themeluara brenda institucionit. Një zyrtar nuk mund të kompensohet për pjesëmarrjen në Komisione të tilla si: Komisioni Disiplinor, Komisioni i Brendshëm i Ankesave (për institucionet që kanë të tillë); Komisione për Vlerësim, Komisione për Rekrutim, Komisionet për Shit/Blerjen e Banesave, Komisione që lidhen me procedura të Prokurimit, Komisione/Grupe Negociuese dhe komisione/borde të ngjashme.
6. Komisione/Borde të themeluara brenda institucioneve, nënkupton rastet kur kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit/Bordit të gjithë janë të punësuar në institucionin që nxjerr vendimin për themelim të Komisionit/Bordit.
7. Paragrafi 2.6 i nenit 5 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2023, zbatohet vetëm në raste kur Komisioni/Bordi është i themeluar brenda institucionit, sipas pikës 6 të kësaj Qarkoreje.



8. Në rastet kur përbërja e Komisioni/Bordi është nga institucione të ndryshme, kryesuesi dhe të gjithë anëtarët e Komisionit/Bordit kanë të drejtë të kompensohen, duke përfshirë edhe anëtarët të cilët janë të punësuar në institucionin që ka nxjerrë vendimin për themelimin e Komisionit/Bordit. Kjo vlen për Komisionet/Borde që janë tërësisht ndryshe nga përshkrimi i detyrave të punës – si p.sh Komiteti i Auditimit të Brendshëm, Komisioni për Vlerësim të Dëmeve të Shkaktuara nga Fatkeqësitë Natyrore, Komisionet e ndryshme të themeluara nga Qeveria me përbërje të Institucioneve tjera. Ky kompensim nuk vlen për të gjitha Komisionet edhe sikur përbërja e tyre të jetë me zyrtarë të institucioneve të ndryshme, nëse në mënyrë kumulative nuk janë plotësuar kriteret e pikës 3. të kësaj Qarkore.

Procedura e kompensimit

9. Institucioni që themelon Bordin apo Komisionin sipas përcaktimeve të kësaj Rregulloreje, në Vendimin e themelimit parasheh të drejtën për kompensim të anëtarëve të Bordit apo Komisionit.
10. Kërkesa për kompensim nga kryesuesi i Komisionit/Bordit për të gjithë anëtarët, dërgohet tek Zyrtari më i Lartë Administrativ (ZKA) i Institucionit që ka nxjerrë vendimin.
11. Në rast të vendimeve të nxjerra nga Qeveria e Republikës së Kosovës, kompensimi bëhet nga organizata buxhetore që ka propozuar themelimin e Komisionit/Bordit.
12. ZKA, kërkesën e aprovuar e përcjell për ekzekutim të kompensimit për të gjithë anëtarët e Komisionit/Bordit, tek Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore e atij institucioni që ka nxjerrë vendimin për themelimin e Komisionit apo Bordit, respektivisht të Institucionit që ka propozuar themelimin e Komisionit/Bordit në rastin e vendimeve të nxjerra nga Qeveria.
13. Komisionet/Bordet që në vendimin për themelimin nuk e kanë të përcaktuar çështjen e kompensimit, duke përfshirë edhe ato që kanë qenë të themeluara në momentin e hyrjes në fuqi të Rregullores (QRK) Nr. 10/2023, kërkesën e arsyetuar me shkrim për kompensim e dërgojnë për aprovim tek ZKA i institucionit që ka nxjerrë vendimin për themelimin e Komisionit/Bordit.
14. ZKA i Institucionit pas pranimit të kërkesës sipas pikës 9. të kësaj Qarkoreje, e shqyrton kërkesën dhe vendos për aprovim nëse Komisioni/Bordi plotëson kriteret e përcaktuara në Rregulloren (QRK) Nr. 10/2023. Në të kundërt, ZKA nxjerr vendim me shkrim për refuzim të kërkesës, në rast se konsideron se kriteret e Rregullores (QRK) Nr. 10/2023 nuk janë përmbushur.
15. Në rastet kur ZKA aprovon kërkesën sipas pikës 9. të kësaj Qarkoreje, kërkesën për ekzekutim të kompensimit për të gjithë anëtarët e Komisionit/Bordit, e përcjell tek Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Institucionit që ka nxjerrë vendimin për themelimin e Komisionit/Bordit, respektivisht të Institucionit që ka propozuar themelimin e Komisionit/Bordit në rastin e vendimeve të nxjerra nga Qeveria.

**Qarkore rreth zbatimit të Rregullores (QRK) Nr. 10/2023 për Kompensimin për
Funksionin Shtesë**

1. Rregullorja (QRK) Nr. 10/2023 për Kompensimin për Funksionin Shtesë është publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe ka hyrë në fuqi më 6 shkurt 2023, në përputhje me nenin 38 të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik.
2. Rregullorja përcakton kriteret për kompensim të zyrtarëve publik të cilët emërohen/caktohen që të shërbejnë në borde, komisione profesionale apo organe tjera publike, që kërkojnë ekspertizë profesionale dhe përbëjnë funksion shtesë nga detyrat e punës së zyrtarit publik.
3. Rregullorja ka përcaktuar kriteret për përfitim të këtij kompensimi, të cilat duhet të përmbushen në mënyrë kumulative:
 - 3.1. themelimi i Komisionit/Bordit parashihet në ligj apo akt nënligjor;
 - 3.2. përfshirja në Komision përbën funksion shtesë për zyrtarin publik;
 - 3.3. funksioni nuk bën pjesë tek detyrat e obligueshme të pozitës të cilën zyrtari publik e mban;
 - 3.4. përfshirja në Komision kërkon ekspertizë profesionale të cilën zyrtari e posedon;
 - 3.5. Komisionet/Bordet të cilat kanë kompetenca vendimmarrëse në procedurë administrative; dhe,
 - 3.6. Komisioni/Bordi nuk themelohet nga institucioni ku zyrtari publik është i punësuar.
4. Rregullorja përcakton se kompensim për funksion shtesë në asnjë mënyrë nuk iu takon zyrtarëve që caktohen të shërbejnë në ndonjë grup, ekip punues, autoritet apo organe të ngjashme, dhe shërbimi konsiderohet pjesë e detyrave të obligueshme të zyrtarit. Rrjedhimisht, zyrtarët nuk mund të kërkojnë Kompensime për pjesëmarrje në grupe punuese për hartim të legjislacionit, strategjive, politikave dhe të ngjashme, pavarësisht se a hartohet dokumenti në institucionin ku janë të punësuar, apo delegohen si përfaqësues të institucionit përkatës në një institucion tjetër publik.
5. Kompensimi gjithashtu nuk u takon zyrtarëve për kryerjen e detyrave dhe përgjegjësi që rrjedhin nga pozita që e mbajnë, duke përfshirë këtu edhe pjesëmarrjen në komisione dhe/apo organe të tjera të themeluara brenda institucionit. Një zyrtar nuk mund të kompensohet për pjesëmarrjen në Komisione të tilla si: Komisioni Disiplinor, Komisioni i Brendshëm i Ankesave (për institucionet që kanë të tillë); Komisione për Vlerësim, Komisione për Rekrutim, Komisionet për Shit/Blerjen e Banesave, Komisione që lidhen me procedura të Prokurimit, Komisione/Grupe Negociuese dhe komisione/borde të ngjashme.
6. Komisione/Borde të themeluara brenda institucioneve, nënkupton rastet kur kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit/Bordit të gjithë janë të punësuar në institucionin që nxjerr vendimin për themelim të Komisionit/Bordit.
7. Paragrafi 2.6 i nenit 5 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2023, zbatohet vetëm në raste kur Komisioni/Bordi është i themeluar brenda institucionit, sipas pikës 6 të kësaj Qarkoreje.



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVO
MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME - MINISTARSTVO UNUTRASNIH POSLOVA
MINISTRY OF INTERNAL AFFAIRS
Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm/Kancelaria e Sekretarit të Përgjithshëm
Office of the Secretary General

Nr./Br./No. 356 Nr. S./Br. sht./No. pg.
Data/Datum/Date 22.03.2023
PRISHTINE-PRISTINA-PRISTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria / Vlada / Government
Ministria e Punëve të Brendshme / Ministarstvo Unutrasnjih Poslova / Ministry of Internal Affairs



DATË/A:	21.03.2023
REFERENC-Ë:	356/2023
PËR/ZA/TO:	Zyrtarët Kryesor Administrativ të Organizatave Buxhetore z. Xhelal SVEÇLA Ministër i Punëve të Brendshme
NGA/OD/FROM:	znj. Fahrije TËRNAVA - SHEREMETI, Sekretare e Përgjithshme e MPB-së
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Qarkore rreth zbatimit të Rregullores (QRK) Nr. 10/2023 për Kompensimin për Funkcionin Shtesë



Të nderuar,

Me qëllim të zbatimit të Rregullores (QRK) Nr. 10/2023 për Kompensimin për Funkcionin Shtesë (këtej e tutje referuar si Rregullorja), mund të gjeni Qarkoren me anë të së cilës ofrohen instruksionet e nevojshme që duhet ndjekur nga institucionet për t'u siguruar zbatimin e këtij akti nënligjor.

Me respekt!



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministartvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Për:	Enis Spahiu, U.d. Sekretar i Përgjithshëm në MFPT		
Kopje:	Kryetari i Komunës së Malishevës Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL		
Përmes:	Jeton Qela, U.d. Sekretar i Përgjithshëm në MAPL		
Nga:	Besim Myrtezani, U.d. Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave	Datë: 09.11.2023 Nr. 020/882	
Zyrtarët përgjegjës:			
1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor	Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave		
2. Zyrtari hartues vlerësimit ligjor	Gafurr Sllamniku, Zyrtar i Lartë për Monitorim të Komunave		
Lënda:	Shkresë përcjellëse për MFPT		
Lloji i aktit:	Vendim		

I nderuar Sekretar,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, ka pranuar Vendimin Nr. 02/513 për caktimin e lartësisë së kompensimit mujor për anëtarët e Komisionit të Aksionarëve, i miratuar nga Kuvendi i Komunës së Malishevës dhe i nënshkruar nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Malishevës, me qëllim të shqyrtimit të detyrueshëm të ligjshmërisë, ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale.

Duke u bazuar në nenin 3, Rregullore (QRK) nr.06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, si institucion përgjegjës po ju dërgojmë për shqyrtimin e ligjshmërisë, aktin e komunës si në vijim:

Vendimin Nr. 02/513 për caktimin e lartësisë së kompensimit mujor për anëtarët e Komisionit të Aksionarëve

I miratuar më datë: 31.10.2023

I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 08.11.2023